



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE SHKODËR

NOTER SABRI M. KURTAJ
ADRESA Koplik
TEL: 682126019

REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

Nr. repertori: 137

Nr. koleksioni: 50

Koplik më 16/01/2024



Sabri
Kurtaj

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten :Sabri
Kurtaj
Data: 2024.01.16
18:10:58+01:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024040020004852881



A2024040020004852881

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
i Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar
“GESI CONSTRUCTION 2024 “ shpk

Sot me datë 16.01.2024 , ditën e martë, para meje **Sabri M. Kurtaj**, noter anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë dega vendore Shkoder, pajisur me Leje Profesionale nr 1872 datë 03.04.2001, me zyrë në adresën Qendër Koplík, bashkia Malësi e Madhe u paraqit personalisht;

THEMELUESI:

Unë **Bujar Hasaj**, atësia Binak, amësia Nure, shtetas Shqiptar, lindur në Sterbeq, Shkodër dhe banues në MALËSI E MADHE, me adresë Kurtulajve 03650022; Nd. 4; H. 1; Koplík; Koplík; 4301; Malësi E Madhe, lindur më 15/08/1978, gjendja civile “i martuar”, me nr. personal H80815189M ,mbajtës I dokument identifikimi ID nr . 033540459 . me iniciativen time të lirë si dhe duke u bazuar ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise ,Kodin Civil ne fuqi, ne mbeshtetje te Ligiit nr.9901 date 14. 04. 2008 "Per Shoqerite Tregtare, liglit nr. 9723 date 03.06.2007 "Per Qendren Kombetare te Reglistrimit" atë Doganor, Fiskal ,Tatimor në R Shqiperisë, **Vendosa** të krijoj Shoqërinë Tregtare Shqiptare me Përgjegjësi të Kufizuar “GESI CONSTRUCTION 2024 “ shpk për sa më poshte vijon :

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Shoqëria me emrin “GESI CONSTRUCTION 2024 “ shpk është themeluar në bazë të Aktit Themelimit, sipas ligjit Nr 9901 datë 14.02.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” I ndryshuar me ligjin Nr 10475 datë 27.10.2011, dhe me ligjin Nr 129/2014 datë 02.10.2014, si dhe me ligjin 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombetare të Regjistrimit” I ndryshuar me ligjin Nr 9916 datë 12.05.2008, me ligjin Nr 92/2012 datë 27.09.2012 dhe me ligjin Nr 8/2015 datë 09.02.2015 si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 1 Emri dhe forma juridike

-Emri dhe emërtimi tregtar I shoqërisë është “GESI CONSTRUCTION 2024 “ shpk
-Shoqëria “GESI CONSTRUCTION 2024“ shpk është një person juridik privat I themeluar në bazë të ligjit Nr 9901 datë 14.02.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” I ndryshuar , më pas referuar si “Ligji” në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
-Shoqëria ka fituar personalitetin juridik, me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar që mbahet nga Qendra Kombetare e Biznesit (më pas referuar si QKB) në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligjet në Republikën e Shqiperisë. .

Neni 2 Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është: Ndertime me karakter civil dhe ekonomike, industrial, turistike bujqesore deri dhe mbi 5 kate, banesa, rrugë ,infrastruktur, kanale e impiante vaditese . Ndertime ujsjellësa kanalizime urbane e rurale ujsjellësa të jashtëm e kolektorë shkarkimi, Projektim dhe zbatim i veprave ndertimore, Kryerja e investimeve ne te gjitha fushat dhe kryesisht per ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore ne infrastrukture etj. Zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit te sherbimeve, kerkimeve, konsulences, projekteve dhe studimeve te te gjitha llojeve, si dhe çdo operacion tjetër që bashkohet me



A2024040020004852881

veprimtaritë e mësipërme e që konsiderohet i përshtatshëm e me leverdi për rritjen e zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteti të shoqërisë etj, Prodhim, perpunim i materialeve të industrisë së rëndë dhe të lehtë ushqimore tregtim me shumice e pakice, transportim, magazinim dhe shpërndarje e mallrave dhe materialeve, investime në fushat, ndërtim, komunikacion, tregti, shërbime të tjera, kafene restorante, salla lojrash, përfaqësim, ndërmjetësim, tranzitim të mallrave dhe të shërbimeve ,marketing etj. Grumbullim, perpunim, trajtim reciklimi dhe transport mbetjesh urbane, inerte etj. Ndërtim dhe tregtim të godinave familjare dhe tregtare, transport për llogari të të tretëve. Prodhimin, grumbullimin dhe shitblerjen e artikujve të ndryshëm, si dhe import eksport të të gjitha mallrave të ndryshme . Prodhime dhe montime me materiale të porositësit si dhe me materialet tona. import eksport, tregtim i artikujve të ndryshëm me shumicë e pakicë si industriale, elektroshtëpiake, materiale ndërtimi, hidrosanitare, bujqësore, blegtorale, ushqimore, makineri e pjesë këmbimi, vegla auto, agjenci transporti, transport mallrash dhe udhëtarësh si dhe çdo aktivitet tjetër tregtar të lejuar nga ligji .

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar kohor.

Neni 4 Selia dhe adresa e shoqërisë.

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në Koplik, bashkia Malësi e Madhe me adresë "Rruga e Kurtulajve 03650022; Nd. 4; H. 1; Koplik; Koplik; 4301; Malësi E Madhe.

4.2 Adresae shoqërisë dhe nr kontakti për qëllime komunikimi elektronik është **gesiconstruction2024@hotmail.com** dhe nr cel +3550603113131

4.3 Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar brenda e jashtë territorit të R Shqipërisë nëpërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit . Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit nr Nr 9901 datë 14.02.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" I ndryshuar

Neni 5 Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të falimentimit të ortakut/ortakëve

5.1 Në rast vdekje apo falimenti. kalimi i kuotes dhe I të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtareve apo personave që fitojnë keto të drejta duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) diteve nga njoftimi i vdekjes apo I falimentimit të ortakut/ortakëve

5.2 Personi që fiton të drejten rmbi kuoten e pjesërnarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të ortakut mund të zgjedhë të bëhet zotëruar I kuotes ose të kalojë regjistrimin e kuotes në emër të një personi tjetër i zgjedhur prej tij si përfitues I kuotes. Nëse personi I mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar I kuotes, ai njofton Shoqërine në lidhje me këtë vendim

KREU II

KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar. Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

6.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000 lek (njëqindmijë)** të depozituara.

6.2 Vlera totale e kapitalit të regjistruar është 100 000 lekë.

6.3 Kontributet në para do të paguhën menjëherë Pagesat e kontributeve në para do të kryhen në llogarinë bankare.



A2024040020004852881

veprimtaritë e mësipërme e që konsiderohet i përshtatshëm e me leverdi për rritjen e zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteti të shoqërisë etj, Prodhim, perpunim i materialeve të industrisë së rëndë dhe të lehtë ushqimore tregtim me shumice e pakice, transportim, magazinim dhe shpërndarje e mallrave dhe materialeve, investime në fushat, ndërtim, komunikacion, tregti, shërbime të tjera, kafene restorante, salla lojrash, përfaqësim, ndërmjetësim, tranzitim të mallrave dhe të shërbimeve ,marketing etj. Grumbullim, perpunim, trajtim reciklimi dhe transport mbetjesh urbane, inerte etj. Ndërtim dhe tregtim të godinave familjare dhe tregtare, transport për llogari të të tretëve. Prodhimin, grumbullimin dhe shitblerjen e artikujve të ndryshëm, si dhe import eksport të të gjitha mallrave të ndryshme . Prodhime dhe montime me materiale të porositësit si dhe me materialet tona. import eksport, tregtim i artikujve të ndryshëm me shumicë e pakicë si industriale, elektroshtëpiake, materiale ndërtimi, hidrosanitare, bujqësore, blegtorale, ushqimore, makineri e pjesë këmbimi, vegla auto, agjenci transporti, transport mallrash dhe udhëtarësh si dhe çdo aktivitet tjetër tregtar të lejuar nga ligji .

Neni 3 **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar kohor.

Neni 4 **Selia dhe adresa e shoqërisë.**

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në Koplik, bashkia Malësi e Madhe me adresë "Rruga e Kurtulajve 03650022; Nd. 4; H. 1; Koplik; Koplik; 4301; Malësi E Madhe.

4.2 Adresae shoqërisë dhe nr kontakti për qëllime komunikimi elektronik është **gesiconstruction2024@hotmail.com** dhe nr cel +3550603113131

4.3 Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar brenda e jashtë territorit të R Shqipërisë nëpërmjet hapjes së degëve dhe zyrave të përfaqësimit . Hapja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit bëhet sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit nr Nr 9901 datë 14.02.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" I ndryshuar

Neni 5 **Kalimi i kuotave me trashëgimi (Mortis Causa) ose për shkak të falimentimit të ortakut/ortakëve**

5.1 Në rast vdekje apo falimenti. kalimi i kuotes dhe I të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtarëve apo personave që fitojnë keto të drejta duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) diteve nga njoftimi i vdekjes apo I falimentimit të ortakut/ortakëve

5.2 Personi që fiton të drejten rmbi kuoten e pjesërnarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të ortakut mund të zgjedhë të bëhet zotëruar I kuotes ose të kalojë regjistrimin e kuotes në emër të një personi tjetër i zgjedhur prej tij si përfitues I kuotes. Nëse personi I mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar I kuotes, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim

KREU II

KAPITALI

Neni 6 **Kapitali themeltar. Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

6.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000 lek (njëqindmijë)** të depozituara.

6.2 Vlera totale e kapitalit të regjistruar është 100 000 lekë.

6.3 Kontributet në para do të paguhën menjëherë Pagesat e kontributeve në para do të kryhen në llogarinë bankare.



A2024040020004852881

6.4 Kapitali është i ndarë në **një kuotë të vetme 100%** e cila është në zotërim të ortakut të vetëm. Bujar Hasaj zotërues i një kuote të vetme të plotë 100% me vlerë nominale 100 000 lekë (njëqindmijë)

6.5 Ortaku/ortakët kanë të drejtë të tjetërsojnë këtë kapital, të shtojnë apo të pakesojnë kuotat e kapitalit deri në kufijte e përcaktuar nga ligji

6.6 Ortaku/ortakët ka të drejtë të administroj aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund të kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Ka/kanë të drejtë të marrin dijëni për rezultatet ekonomiko financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj. Ka/kanë ne të drejte të marrin pjesë vete ose me anë të përfaqësueseve në këtë aktivitet.

6.7 Ortaku/ortakët ka/kanë të drejtë të tërheqin të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë për tre vjetet e fundit

6.8 Ortaku/ortakët ka/kanë të drejte të heqin dorë nga shoqëria dhe mund të shesin pjesën e kapitalit të tyre në perputhje me kushtet që i lejon statuti dhe ligji.

6.9 Ortaku/ortakët në perputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin në fuqi ka/kanë të drejtë që në të njejten kohë të jenë ortakë edhe në shoqëri të tjera.

6.10 Ortaket rezervojnë të gjitha të drejtat sipas ligjit Tregtar.

Neni 7 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

7.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

7.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

7.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga ortaku/asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statudit.

7.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8 Transferimi i kapitalit. Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave

8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

8.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

8.4 Në rastin e kalimit të kuotave me kontrate, kontrata duhet të behet me shkrim.

8.5 Ortaku/Ortakët e shoqërisë kanë të drejte të përfitojnë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tyre. Shoqëria nuk është e detyruar të leshojë me shume se një certifikatë për kuotat e zotëruara. Certifikata nuk do të gëzojë cilesinë e letres me vlerë.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE



A2024040020004852881

Neni 9 Organi Vendimmarrës

- 9.1 Ortaku/Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 9.2 Ortaku/Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj
- 9.3 Ortaku/Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse/e për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - ndryshimet e statutit;
 - emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 9.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 9.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.
- 9.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10 Administrimi, Emërimi I administratorit.

10.1 Ortaku/Asambleja e Ortakeve emërojnë një ose më shumë persona fizik si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet. me të drejtë ripërtëritje . Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

10.2 Administratori i shoqërisë emërohet z.**Bujar Hasaj** , atësia Binak, amësia Nure, shtetas Shqiptar, lindur në Sterbeq, Shkodër dhe banues në MALËSI E MADHE, me adresë Kurtulajve 03650022; Nd. 4; H. 1; Koplik; Koplik; 4301; Malësi E Madhe, lindur më 15/08/1978, gjendja civile "i martuar", me nr. personal H80815189M ,mbajtës I dokument identifikimi ID nr . 033540459 , për një afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij akti

Neni 11 Kompetencat e Administratorit

- 11.1 Administratori ka të drejtë e detyrohen të:
- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - përfaqësojnë shoqërinë tregtare;



A2024040020004852881

- c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecërisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g. raportojnë përpara ortakut/asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 11.2 Administratori /administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 11.3 Nëse Ortaku/asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 11.4 Ortaku/Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 12 Përgjegjësitë e Administratorit

- 12.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 12.2 Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 12.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
- a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;



A2024040020004852881

- d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 12.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 12.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 12.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- u kthen ortakëve kontributet;
 - u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - jep kredi.
- 12.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- 12.8 Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR, EKSPERTET

Neni 13 Viti Financiar

- 13.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14 Eksperti financiar

- 14.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo viti financiar. Caktimi i tyre e bënë administratori i shoqërisë.
- 14.2 Eksperti kontabël mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit të shoqërisë
- 14.3 Ato përgjigjen për dëmet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.



A2024040020004852881

14.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi .

14.5 Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat që janë në gjini e krushqi deri në shkallen e katert. Po ashtu nuk mund të kryejë këto detyra përgjegjës të zyrave, filialeve e agjensive.

14.6 Eksperti ka për detyra që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

14.7 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 15 Inventari dhe llogaritë vjetore.

15.1 Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore

15.2 Në mbylljen e vitit financiar administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar .

Neni 16 Raportet vjetore

16.1 Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël hartojnë inventarët dhe llogaritë vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe hartojnë një raport me shkrim për ortakët/ortakun.

16.2 Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortakët sipas **Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"**.

KREU V MARDHËNIET E PUNËS

Neni 17 Mardhëniet e punës

17.1 Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çështjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

17.2 Për çdo mos marrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor më Juridiksion të Përgjithshëm Shkoder.

17.3 Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyra vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

KREU VI

MBYLLJA E SHOQËRISË, LIKUJDIMI



A2024040020004852881

Neni 18 Mbyllja e shoqërisë

18.1 Shoqëria me përgjegjesi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohezzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut/Asamblesë ortakëve ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723. datë 3.5.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

18.2 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë nënenet 191 dhe neni 203 të Ligjit 9901.

18.3 Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakut/Asambleja e ortakëve caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e siper".

18.4 Likuiditori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vënë në dispozicion menjëherë ortakut/ortakeve.

18.5 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

18.6 Ortaket vendosin mbi rregullshmerinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

18.7 Ortaket mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakeve ose të një mandat mbajtësi të caktuar prej tij.

18.8 Kur ortakët për shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

18.9 Shoqëria likuidohet me procedure të thjeshtezuar, në përputhje me Nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 19 Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20 Baza Ligjore

20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



A2024040020004852881

20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21 Mosmarrëveshjet

21.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

Neni 22 Dispozitat e fundit

22.1 Për të gjitha ceshtjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e **Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008” Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**

22.2 Per efekt të inteprentimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji nr 9901 date 14.04.2008 “Per Shoqëritë Tregtare”

22.3 Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.

Neni 23 Hyrja në fuqi


Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e nënshkrimit nga ortaku i shoqërisë .

Unë Noteri verifikova identitetin e themeluesit nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË “GESI CONSTRUCTION 2024 “ shpk

Bujar Hasaj



Koplik me 16.01.2024

Noter
Sabri M. Kurtaj



Banka Kombëtare Tregtare : 16-JAN-2024 12:01

TELLER CASH DEPOSIT ALBANIA
TELLER CASH DEPOSIT ALBANIA

KLIENITI: 517226793
EMRI I KLIENTIT: BUJAR HASAJ
ADRESA E KLIENTIT: LLAZAN
KOPLIK KOPLIK/M MADHE
AL/KOPLIK/4301

REFERENCË : 517TCDA240160031
DATE VALUTA/VALUE DATE : 16-JAN-24
LLOGARIA E VEPRIMIT/TXN ACC : 517226793CLIDCLALLSK
AL21 2055 2671 2267 93CL IDCL ALLS
EMERTIMI I LLOGARISË/ACC DESC : BUJAR BINAK HASAJ
SHUMA E VEPRIMIT/TXN AMOUNT : 100,000.00 ALL
OFS ACC : BA1112000
EMERTIMI I LLOGARISË/ACC DESC : BKT
OFS AMOUNT :
KURSI I KËMBIMIT/EXCH RATE : 1 100,000.00 ALL
NR.I CEKUT/CHEQUE NO :
KODI I BANKËS/CLG BANK :

PËRMBLEDHJE E KOMISIONIT/CHARGE/TAX SUMMARY

SHUMA BAZE/BASE AMT : 100,000.00 ALL
TOT TAX : 0.00 ALL
KOMISIONI/TOT CHG : 0.00 ALL
SHUMA NETO/NET AMT : 100,000.00 ALL

BURIMI I TË ARDHURAVE :

PËRSHKRIMI I VEPRIMIT :
BUJAR HASAJ DERDH NE LLOGARI PER KAPITAL FILLESTAR

KLIENITI : EMËR MBIEMËR FIRMË

Bujar Hasaj

Unë konfirmoj me nënshkrimin e këtij mandati se të dhënat e printuara janë të sakta sipas kërkesës time. Ky mandat do të shërbejë si provë për çdo pretendim në të ardhmen.

***** Sipas Kushteve të Punës në fuqi *****

Punonjësi i degës:

vula:

